



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26 Janar 2022

Nr: 11

VENDIM

PËR

**CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE  
ZGJEDHORE NË ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME VENDORE PËR  
KRYETAR BASHKIE TË DISA NJËSIVE VENDORE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe nenit 29, pika 3, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V E N D O S I:**

- Të caktojë masën e shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore si më poshtë:
  - Kryetari dhe zv. kryetari i KZAZ-së në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë, nga momenti i konstituimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
  - Anëtari dhe Sekretari i KZAZ-së në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë, nga momenti i konstituimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
  - Kryetari i KQV-së në vlerën 4.000 (katër mijë) lekë.
  - Anëtari dhe Sekretari i KQV-së në vlerën 3.500 (tre mijë e pesëqind) lekë.
  - Anëtari i GNV-së në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) lekë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

